



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë e Huaj C2 (rusisht)

Ngarkesa: 6 kredite; 60 orë seminare;

Viti / Semestri: Viti I/Semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme / Kategoria B

Programi i studimit: Master i Shkencave në “Komunikim ndërkulturor dhe turistik trigjuhësh”

Kodi i Etikës: Kodi i Etikës së UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJA DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivat e përgjithshme lëndore: Kjo lëndë ka si qëllim të përgatisë studentët për të komunikuar në nivel të avancuar në gjuhën ruse dhe për të kuptuar thellësisht kulturën dhe historinë e Rusisë. Zhvillon aftësitë e studentëve për të komunikuar në mënyrë efektive në situata të ndryshme, përfshirë biseda, shkrimin e teksteve të ndryshme, dhe interpretimin.

Studenti duhet të jetë i aftë të kalojë nga një nivel më i ulët në nivelin pasardhës më të lartë në zotërimin e gjuhës ruse.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Të aftësojë studentët të kuptojnë dhe analizojnë tekste të avancuara në gjuhën ruse, përfshirë tekste letrare, publicistike dhe kulturore, duke vlerësuar strukturën, stilin dhe përmbajtjen.
- 2.Të zhvillojë aftësitë për të komunikuar rrjedhshëm dhe me saktësi në situata të ndryshme akademike dhe kulturore, si në të folur, ashtu edhe në të shkruar.
- 3.Të nxisë përdorimin e gjuhës ruse në mënyrë të pavarur dhe kritike, duke lidhur aspektet gjuhësore me njohuri mbi historinë, kulturën dhe letërsinë ruse.

Rezultatet e pritshme :

- 1.Lënda synon zotërimin praktik të gjuhës ruse, si dhe pajisjen e studentëve me aftësitë dhe shprehjet komunikative bazë (leximi, dëgjim, të folur, shkrim) brenda disa tematikave të njohura dhe mbi bazën e materialit leksiko-gramatikor të përvetësuar.
- 2.Studentët në fund të kursit do të jenë i aftë të përmirësojë të shprehurin me shkrim, me gojë, si dhe aftësinë e argumentimit të situatave të ndryshme.
- 3.Të mësojnë më shumë për historinë, kulturën dhe letërsinë ruse.
- 4.Të zhvillojnë aftësinë për të analizuar dhe interpretuar tekste të rëndësishme në gjuhën ruse, duke përfshirë veprat letrare të autorëve rusë .